

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E STANDARDIZIMIT

RAPORTI VJETOR 2012

Zbatimi i detyrave që dalin nga Plani Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit (PKZMSA), i cili ka reflektuar detyrimet e DPS ndaj nenit 75 të Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit, si dhe rekomandimet e raportit analitik të KE-së të vitit të kaluar ka qenë fokusi kryesor i punës sonë për këtë vit.

Bazuar në sa më sipër prioritetet tona në terma afatshkurtër dhe afatgjatë respektivisht janë:

- Progres i mëtjshëm në adoptimin e standardeve europiane dhe rritje e përpjekjeve për t'u bërë anëtar me të drejta të plota në CEN&CENELEC;
- Përmirësimi i funksionimit të DPS si Organi Kombëtar i Standardeve, duke aplikuar praktikat më të mira europiane;
- Marrja e masave për të rritur ndërgjegjësimin e operatorëve ekonomikë në lidhje me konceptet e standardeve dhe rëndësinë e përdorimit të tyre në produktet dhe shërbimet që ofrohen në tregun e brendshëm dhe në tregtinë rajonale e ndërkombëtare;
- Pjesëmarrja në punën Europiane e ndërkombëtare të standardizimit dhe trajnimi i stafit me praktikat dhe procedurat e punës së organizmave homologe.

Ç'farë është realizuar gjatë këtij viti:

Përafrimi i legjislacionit

Në kuadrin e përafrimit të legjislacionit tonë me atë të vendeve të BE-së dhe bazuar edhe nga sa parashikohet në PKZMSA,

Legjislacioni në fushën e Standardizimit është si më poshtë:

- Ligji nr. 9870, datë 04.02.2008 "Mbi Standardizimin" (Fletorja zyrtare nr.18, 19/02//2008);
- Ligji nr.10384, datë 24.02.2011 (Fletorja zyrtare nr. 25, 25/03//2011) "Mbi disa ndryshime në Ligjin mbi Standardizimin";
- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.789, datë 22.07.2009 "Për notifikimet në zbatim të Marrëveshjes së WTO/TBT dhe WTO/SPS";
- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.433, datë 5.5.2010 "Mbi krijimin, përbërjen, mënyrën e funksionimit dhe kompetencat e Bordit drejtues të DPS-së";

Gjatë 2012 u miratua:

- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.190, datë 13.3.2012 "Per Kodin e hartimit, adoptimit, miratimit dhe zbatimit te standardeve", i cili ngarkon DPS me detyrën e zbatimit të parashikimeve të dhëna në Aneksin 3 të Marrëveshjes së OBT mbi Barrierat Teknike në Tregti

Gjithashtu, në përputhje me rregulloret e brendshme të CEN&CENELEC, krahas atyre ekzistuese të tilla si:

- Udhëzues për Delegatët Shqiptarë që marrin pjesë në komitetet teknike të standardizimit në nivel evropian dhe ndërkombëtar;
- Rregullorja mbi veprimtarinë dhe funksionimin e Forumit Kombëtar të Standardizimit;
- Përbërja e Bordit Teknik dhe mënyra e funksionimit të tij;
- Notifikimet e standardeve kombëtare S SH EN në CEN&CENELEC;
- Proçedura e Pezullimit (*Standstill*);
- Rregullat dhe Procedurat për Veprimtaritë Kombëtare të Standardizimit;

Gjatë 2012 u miratua edhe rregullorja e brendshme:

- Shpërndarja dhe Shitja e Standardeve.

Me asistencën e projektit BERIS këtë vit në DPS filloi nga funksionimi Databaza e DPS-së – Sistemi i informacionit dhe menaxhimit të standardeve.

Databaza siguron ndër të tjera:

1. Regjistrimin e standardeve shqiptare si ato të publikuara dhe ato që janë në fazë projekti
2. Regjistrimin dhe përditësimin automatikisht të të dhënave mbi standardet dhe projekt standardet e organizmave CEN, CENELEC, ISO, IEC, ETSI.
3. Regjistrimin e të dhënave mbi KT të DPS si dhe të dhenat mbi KT ndërkombëtare. Këto të fundit shkarkohen automatikisht nga databazat e CEN, CENELEC, ISO, IEC, ETSI.
4. Gjenerimin automatikisht të listave me standarde për notifikim në CEN dhe CENELEC.
5. Gjenerimin e para-faturave dhe faturave për klientet që duan të blejnë standarde.

Kjo databazë është e lidhur me faqen e internetit të DPS. Ndryshimet në të reflektohen në kohe reale në katalogun online që ndodhet në faqen e DPS (www.dps.gov.al).

Gjatë vitit është punuar me ritme të larta për plotësimin, korrigjimin dhe përditësimin e të dhënave të standardeve në databazën e re.


Adoptimi i standardeve Europiane

Gjatë vitit 2012 kanë funksionuar 60 Komitete Teknike (KT) të cilët janë pasqyrë e KT-ve të CEN dhe CENELEC. Në këto KT për adoptimin e standardeve të planifikuara nga Bordi Teknik i DPS-së janë aktivizuar rreth 170 ekspertë, të cilët vijnë nga sektorët privat dhe shtetëror, institucione shkencore, administrata publike, etj.

Gjithsej janë adoptuar mbi 93% e totalit të standardeve EN të të dy organizmave evropiane të standardizimit, CEN dhe CENELEC. Për 2012 janë adoptuar 1786 standarde, 377

amendamente dhe 206 dokumenta standardizimi, nga të cilat 1643 janë standarde evropiane (1392 standarde të publikuara nga CEN dhe 251 standarde të publikuara nga CENELEC) dhe 143 janë standarde ndërkombëtare (70 standarde të publikuara nga ISO dhe 73 standarde të publikuara nga IEC).

Grafiku i mëposhtëm paraqet gjendjen aktuale të Standardeve Shqiptare dhe strukturën sipas llojeve:



Lloji	SSH	SSH EN	SSH ISO+IEC	Të tjera	Totali
Standarde	3055	16399	2551	744	22949

Janë adoptuar 100% e standardeve Evropiane të harmonizuara si Standarde Shqiptare të harmonizuara.

Adoptimi i standardeve është bërë me metodën me perkthim te faqes së parë. Numri i standardeve të perkthyer në shqip është shumë i vogël krahasuar me totalin e adoptimeve.

Gjatë vitit 2012 janë shfuqizuar 876 standarde evropiane (513 janë standarde të CEN dhe 363 janë standarde të CENELEC) dhe 10 standarde ndërkombëtare nga të cilat 8 janë të ISO, 104 amendamente dhe 22 dokument standardizimi, të shfuqizuara nga organizmat përkatëse. Gjate kësaj periudhe janë shfuqizuar dhe 83 standarde puro shqiptare.

Anëtarësimi me të drejta të plota në CEN&CENELEC

Për plotësimin e dosjes së 9 kushteve për anëtarësim të plotë në Organizmat Evropiane të Standardizimit CEN&CENELEC dhe bazuar në Urdhrin e Brendshëm të Drejtorit të Përgjithshëm të DPS-së, dt. 28.02.2012 “Për ngritjen e grupit të punës për përgatitjen e dosjes për të aplikuar për anëtarësim në CEN dhe CENELEC” u ngrit grupi i punës që punoi për evidentimin e plotësimit të të gjitha kriterëve teknike siç kërkohen nga këto organizma. Në këtë kuadër, përveç konsultimit të rregulloreve të brendshme, materialeve të ndryshme (formate, procedura, etj të CEN&CLC dhe ISO), legjisllacionit në fuqi për fushën e stanardizimit, nxjerrjes dhe evidentimit të detajuar të mënyrës së organizimit dhe funksionimit

të të gjithë veprimtarisë së standardizimit në Shqipëri, u rishikuan edhe të gjitha procedurat e punës së DPS.

Dorëzimi i kërkesës në CEN & CENELEC sëbashku me dokumentacionin përkatës do të bëhet kur Shqipëria të ketë plotësuar kriterin politik - Kriteri A - *Duhet të ketë një "Marrëveshje me Europën" (ose ekuivalenti) midis EU / EFTA dhe Shqipërisë, ku të jetë specifikuar një periudhë kalimtare deri në anëtarësimin e plotë në BE/EFTA.*

Ndërkohë, rishikimi, plotësimi dhe azhurnimi i vazhdueshëm i këtyre materialeve do të vazhdojë nga i gjithë stafi i DPS-së veçanërisht nga kordinatorja e grupit të punës.

Faqja e internetit

Gjatë këtij viti DPS-ja është prezantar me faqen e re të internetit me adresë www.dps.gov.al, e cila është më operacionale, më komunikuese me grupet e interesit. Në faqe janë pasqyruar informacionet më të fundit rreth aktivitetit të DPS-së dhe arritjet në fushën e standardizimit. Aty janë dhënë procedurat për kërkimin dhe gjetjen e standardeve që posedon DPS-ja. Po ashtu janë pasqyruar rregullisht notifikimet e standardeve të adoptuara në CEN/CENELEC dhe ISO/IEC, mbledhjet e Bordit Dretjtues, Bordit Teknik, Dita Botërore e Standardeve si dhe aktivitetet e rëndësishme kombëtare dhe ndërkombëtare. Faqja përmban të gjithë buletinët informativë dhe katalogun e Standardeve Shqiptare 2012, si dhe guidën për përdorimin e saj.

Buletinët

Në kuadrin e sigurimit të transparencës dhe gjithëpërfshirjes në aktivitetin e standardizimit janë publikuar për këtë vit 3 buletine me numër 50, 51, 52. Buletini i katërt (nr.53) do të publikohet në ditët e para të Janarit 2013.

Publikimi i buletineve është bërë në letër (të disponueshëm në ambjentet e DPS-së), është dërguar në ministrinë dhe kompani, firma apo individë privatë elektronikisht, si dhe gjenden online në faqen e internetit www.dps.gov.al, duke dhënë një informacion të hollësishëm për standardet e sapo adoptuara, standardet e shfuqizuara dhe duke kërkuar mendimin publik për ato standarde që kanë statusin e draft-standardeve.

Publikimi i katalogut

Katalogu i Standardeve Shqiptare përmban të gjitha standardet puro shqiptare në fuqi, ato të adoptuara si dhe standardet e shfuqizuara dhe botohet çdo vit. Katalogu i Standardeve Shqiptare 2012 është shpërndarë në format letër dhe me CD. Gjithashtu, si rezultat i funksionimit të plotë të databazës së DPS është bërë e mundur që të reflektohen në kohe reale në katalogun online të gjitha azhurnimet që i bëhen Standardeve Shqiptare. Kjo i mundëson të gjithë të interesuarve që përdorin Katalogun e Standardeve Shqiptare të gjejnë informacionin më të fundit online lidhur me standardet. Në faqe gjenden edhe udhëzuesit e përdorimit në shqip dhe anglisht.

Aktivitete të organizuara

U organizua takimi për Ditën Botërore të Standardeve, 14 Tetori 2012, ku morën pjesë mbi 20 persona, kryesisht nga kompanitë private. Celebrimi i kësaj dite si çdo vit i kushtohet

kontributit të të gjithë pjesëmarrësve në procesin e hartimit dhe miratimit të standardeve, veçanërisht anëtarëve të Komiteteve Teknike. Tema për këtë vit ishte “Rritja e efikasitetit nga përdorimi i standardeve, duke sjellë ulje të humbjeve dhe rezultate më të mira”.

Marrëveshjet

Është lidhur Memorandumi i Mirëkuptimit ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Standardizimit të Republikës së Shqipërisë dhe Institutit të Standardeve të Azerbajxhanit. Gjithashtu, është miratuar nga Bordi Drejtues Marrëveshja e Bashkëpunimit ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Standardizimit të Republikës së Shqipërisë dhe Institutit të Standardizimit të Republikës së Kroacisë (HZN), e cila pritet të hyjë në fuqi me miratimin e Ministrisë së Ekonomisë të Republikës së Kroacisë.

Publikimet

Janë shpërndarë gjatë vitit publikimet dhe broshurat e përgatitura nga DPS, disa nga të cilat janë si vijon:

- Katalogë të SSH 2012 në format letër rreth (300 copë) dhe CD (400 copë);
- Buletinët informativë periodikë të DPS në format letër dhe elektronikisht me e-mail;
- Fletëpalosje të DPS;
- Fletëpalosje mbi Direktivat e Neë Approach-it;
- Broshura mbi Përfitimet nga përdorimi i standardeve;
- Standardizimi një garanci më shumë.


Përmirësimi i kushteve për klientët

Është përmirësuar mjedisi i pritjes së vizitorëve/ klientëve në DPS, në të cilin janë vendosur stenda me materiale promovuese dhe informuese si dhe është vendosur një monitor (*screen*) ku janë paraqitur në formën e slide-ve apo njoftimeve materiale të ndryshme informuese e promovuese ku përfshihen artikuj mbi standarde, informacion rreth DPS, një material informues mbi ligjin e ri të standardizimit, njoftime mbi aktivitete në organizim, materiale shpjeguese se çfarë është një standard, pse adoptojmë standardet europiane e ndërkombëtare, etj.


Shitja e standardeve

Gjatë këtij viti janë shitur gjithsej **1758** standarde (përkundrejt **805** standardeve në 2011), nga të cilat për këtë vit **1464** standarde janë standarde Europiane (SSH EN) përkundrejt **789** standardeve SSH EN që janë shitur gjatë 2011. Shitja e standardeve shqiptare është bërë sipas legjislacionit në fuqi, rregulloreve 10 dhe 12 të CEN&CENELEC dhe marrëveshjeve ndërkombëtare (midis organizmave të standardizimit).

Grafiku i mëposhtëm jep situatën e shitjeve për vitin 2012:



Totali i standardeve të shitura gjatë 2012 dhe standardet me origjinë europiane (SSH EN) krahasuar me të nejtët tregues të 2011 jepen si vijon:



Notifikimet

Lidhur me detyrimet që kemi si Pikë Referimi e OBT, gjatë këtij viti janë qarkulluar rregullisht të gjitha notifikimet e marra nga vendet anëtare të OBT, në të gjithë ministrinë dhe institucionet shtetërore, sipas përkatësisë. Duhet theksuar se komunikimi me ministrinë e linjës përsa i përket notifikimeve dhe kërkesave për informacione të ndryshme që lidhen me fushat që ato mbulojnë është i mirë.

Gjatë këtij viti janë notifikuar në Sekretariatit e OBT-së në Gjenevë **16 notifikime shqiptare (TBT)** të projekt ligjeve të ardhura nga ministrinë e linjës dhe janë ndjekur me korrektësi të gjitha komentet e ardhura nga subjekte të ndryshme në lidhje me këto notifikime, si dhe **12 notifikime shqiptare (TBT)** në Komitetin e Përbashkët të CEFTA*.

Janë kryer notifikimet e programeve të punës 6 mujore të standardeve në Qendrën e Përbashkët të Informacionit të ISO/IEC.

Është kryer përgatitja e njoftimeve dhe notifikimi në CEN dhe CENELEC për standardet e reja kombëtare (adoptimin e standardeve EN si SSH) nëpërmjet *iPROJEX*-it, në zbatim të procedurave të punës. Një punë voluminoze u krye në vijim të *e-mail*-it të dërguar nga asistentja e drejtores së Marrëdhënieve me Jashtë të CEN/CLC (Programi *iPROJEX*), u bënë verifikime dhe krahasime me standardet tona të adoptuara dhe ato të notifikuara në CEN.

Pjesëmarrja në aktivitete ndërkombëtare

Gjatë këtij viti pjesëmarrja në aktivitete europiane dhe ndërkombetare konsiston në:

- Seminar ndërkombëtar mbi pjesëmarrjen e Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme (SME) në procesin e Standardizimit – Bruksel, Belgjikë;
- Takim ndërkombëtar për Standardet Hallall dhe Infrastrukturën në përputhje me vendet e OIC” (Vendet Islamike);
- Kurs rajonal trajnimi për marketingun dhe promovimin e standardeve ndërkombëtare (ISO) për vendet në zhvillim – Bukuresht, Rumani;
- Asambleja e Përgjithshme e CEN&CENELEC – Krakovë?,Poloni;
- Asambleja e Përgjithshme e ISO - ...Amerikë;
- ...26000...

*Shkresa zyrtare e Zv.ministrit të METE, n° 4594 prot, datë 20 qershor 2011, shpreh se, Shqipëria në bazë të Vendimit të Këshillit të Ministrave n° 789 ka emëruar Drejtorinë e Përgjithshme të Standardizimit, si autoritetin e njoftimit për të kryer detyrimet sipas nenit 13 të kapitullit IV të Marrëveshjes CEFTA.

Sektori i finances, burimeve njerezore dhe sherbimeve mbeshtetese për periudhën Janar – Dhjetor 2012, punën e ka ndërtuar mbi dispozitat ligjore e nënligjore, detyrat e përcaktuara në rregulloren e brëndshme të DPS –së si edhe në udhëzimet e herëpashershme të Ministrisë së Financave .

Mbi këtë bazë është bërë planifikimi dhe detajimi i buxhetit të vitit 2012, duke kryer në kohë rakordimet përkatëse me Degën e Thesarit, është nxjerrë bilanci kontabël vjetor i DPS-së për periudhën janar- dhjetor 2011, i cili është dorëzuar brënda afateve të përcaktuara nga Ministria e Financave, është bërë planifikimi i prokurimeve mbështetur në kerkesat, inisjativat dhe aktivitete e planifikuara te DPS-se si edhe jane mbajtur te gjitha evidencast kontabile sipas kerkesave te ligjit “ Per Kontabilitetin”.

Per vitin 2012 DPS-se ju cel fond buxhetor ne shumen 27.675 mije leke. Nderkohe fondi i celur per investime ne shumen 1.000 leke erdhi me kod M040141.(i ngurtesuar).

Gjate vitit 2012 jane bere koregjime fondi si me poshte:

Fondi i vecante u administrua nga METE dhe DPS-ja perdori nga ky fond vleften prej 187.5 mije leke nga te cilat 27.5 mije leke u kaluan ne art. 602 dhe u perdoren per festen e 8 marsit dhe 160.mije leke nga fondi i vecante u perdoren per festat e fund vitit. Ne te dy rastet u respektuan procedurat sipas udhezimit nr 2/1, date 15.02.2012, “Per zbatimin e buxhetit te vitit 2012” .

U ndoqen me prioritet procedurat per cbllokimin e fondit te investimeve dhe pjesmarjen ne tenderin e organizuar nga Njesia e Prokurimeve te Perqendruara prane Ministrise se Brendshme. Me efikasitet u perdor fondi i mbetur prej 345 mije leke duke bere ne kohe kalimin e kesaj shume nga projekti “blerje paisje kompjuterike’ ne projektin, “blerje paisje zyre”.

Ne artikullin 600 gjate vitit 2012 u be shtese fondi ne shumen prej 220 mije leke si rrjedhoje e rritjes se pagave ne 16.07.2012.

Nisur nga fakti qe shpenzimet operative me te domosdoshme nuk mund te kryheshin me fondin buxhetor ne dispozicion ne muajin tetor 2012, DPS kerkon transferim fondi nga art. 601 ne art. 602 perkatesisht ne shumen 700 mije leke . Kjo kerkese miratohet dhe krijon mundesine e shlyerjes se shpenzimeve me kryesore per zhvillimin normal te aktivitetit te ne DPS.

Ne art. 605 ne muajin tetor Min Fin pakson fondet me 397.730 leke.

Pas ketyre koregjimeve plani ne total per vitin 2012 mbetet ne **shumen ta shofi leta..**

Ne pasqyren me poshte jepen te dhena mbi celjen dhe rishikimin e planit buxhetor (ne leke)


Grupi	Titulli	Kap.	Pershkrimi	Artikull	Plani vjetor	Plani i rishikuar	Plani pas rishikimit
4	160	01	Dr.Pergj.standardizimit	600	14,175,000	380.000	14.555.000
4	160	01	Dr.Pergj.standardizimit	601	3.000.000	(700.000)	2.300.000
4	160	01	Dr.Pergj.standardizimit	602	3,500,000	727.500	4.227.500
4	160	01	Dr.Pergj.standardizimit	605	7.000.000	(397.730)	6,602.270
4	160	01	Dr.Pergj.standardizimit	231	1,000,000		1.000.000
			TOTALI		28.675.000	9.770	28.684.770

Mbeshtetur ne fondet e planifikuara eshte patur kujdes qe te shpenzohet ne funksion te realizimit te objektivave me kryesore te DPS-se, duke kontrolluar progresivisht shpenzimet sipas artikujve dhe analizave perkatese.

Realizimi i treguesëve të buxhetit kundrejt planit vjetor për periudhën janar – dhjetor 2012 paraqitet si më poshte:

KOD	GR	PROG	KAP	ART	BUXHETI	SHPENZ	XHIR	BANKA	DIF	NR PUNONJ	
						THESARI	BREND SH		-BANKA	PLAN	FAKT
						I	N	O=I+J-K-L-M-N	P=I-O		
1004108	04	04160	01	600	14,555,000	14,301,072		14,301,072	-	16	16
1004108	04	04160	01	601	2,300,000	2,233,040		2,233,040	-		
1004108	04	04160	01	600999	16,855,000	16,534,112	-	16,534,112	-		
1004108	04	04160	01	602	4,227,500	4,227,500	87,666	4,139,834	87,666		
1004108	04	04160	01	603				-	-		
1004108	04	04160	01	604				-	-		
1004108	04	04160	01	605	6,602,270	6,602,270		6,602,270	-		
1004108	04	04160	01	606				-	-		
1004108	04	04160	01	230				-	-		
1004108	04	04160	01	231	655,000	654,281		654,281	-		
1004108	04	04160	01	231	345,000	341,800		341,800	-		
1004108	04	04160	01	6029999	11,829,770	11,825,851	87,666	11,738,185	87,666	-	-
					28,684,770	28,359,963	87,666	28,272,297	87,666		

Grafikisht te dhenat e mesiperme



Siç shihet edhe grafikisht:

Artikulli 600 (paga, shpërblime e të tjera shp. personeli) është realizuar ne shumen 14.301 mijë lekë kundrejt 14.555 mijë lekë që është plani vjetor ose në masën 98.2%. Kjo tregon per nje planifikim te drejtë dhe ndjekje korrekte në realizimin e shpenzimeve per kete artikull.

Artikulli 601 (kontrib. për sig. shoq. e shënd.) është realizuar ne shumen 2.233 mijë lekë nga 2.300 mijë lekë që është plani ose ne masen 97%. Vlen te theksohet se jane ndjekur ne vazhdimesi dhe jane derdhur ne kohe detyrimet ndaj shtetit per sigurimet shoqerore e shendetesore, duke aplikuar drejt perqindjet dhe limitet e miratuara per kete qellim

Artikulli 602 (mallra e shërbime të tjera) është realizuar ne shumen 4.227. mijë lekë nga 4.227 mijë lekë që është plani vjetor, ose në masën 100%. U be e mundur mbyllja ne kohe e te gjitha detyrimeve ndaj subjekteve gjate ketij viti.

Për përdorimin e fondeve për këtë artikull, sipas analizave, është zbatuar procedura e prokurimit me vlerë të vogël. Nga komisioni i blerjeve eshte punuar me seriozitet per te zbatuar me korrektesi udhezimet, “ Per proceduren e prokurimit me vlera te vogla “ si edhe udhezimin nr 30, date 27.12.2011, te Ministrise Financave, “Per menaxhimin e aktiveve ne njesite e sektorit public”.

Realizimi i këtij artikulli sipas analizave paraqitet si më poshtë:

Artikull	Analize	pershkrimi	plani vjetor 000/leke	realizimi	
				12 mujori 000/leke	ne 12 mujori ne %
602			4.227	4.227	100 %
	602/2001	kancelari		65	
	602/2002	Mat pastrimi e elctr.		93	
	602/2003	mat.per funks.e pj. te zyr,e te pergj zyre.		72	
	602/1007	abonim		56	
	602/2001	en. elektrike		758	
	602/2002	Shp uji		19	
	602/2003	shp. telefonike	-	665	
	602/2004	Shp postare		10	
	602/2008	Shp per roje godine		500	
	602/2010	Shp printimi e publikimi		358	
	602/4200	Shpenzime udhetimi	-	824	
	602/5300	Shp mirembajtje godine		292	
	602/5500	Shp per miremb e paisjeve		51	
	602/7400	Shp per ekz te vendim gjqesore		188	
	602/9002	Shp per pritje eaktivitete		33	
	602/9005	Shp per honorare		70	
	602/90	Te tjera operative	-	173	

Artikulli 605 (transf. korente për org. ndërk), është realizuar ne shumen 6.602 mijë lekë. Likujdimi i detyrimeve ndaj organizmave nderkombetare si ISO; IEC; CEN; CENELEC eshte pare me precedence dhe eshte kryer ne kohe, duke realizuar 100% likujdimin e detyrimit ndaj organizmave nderkombetare.

Artikulli 231, planifikuar ne shumen 1.000 mije leke.

Ne perputhje me VKM nr. 53. dt. 21.01.2009, u dergua per tenderim vlefta limit 825 mije leke pa TVSH per “blerje paisje elektronike” ne Njesine e Zhvillimit te Prokurimeve te Perqendruara”, prane Ministrise se Brendshme.

Ne perfundim te procedurave u lidh kontrata dhe u bene hyrje ne magazine paisje elktronike ne shumen 654 mije leke.

Nisur nga fakti qe fondi i celur ne art. 231 ishte per paisje kompjuterike mbeshtetur ne nevojat e institucionit u kerkua transferim fondi per vleren 345 mije leke nga projekti, “blerje paisje kompjuterike” ne projektin, “blerje paisje zyre”. Ne perfundim te miratimit nga Ministria e

Finances nepermjet prokurimit me vlera te vogla u be e mundur blerje e paisjeve ne shumen 342 mije leke. Ne perfundim investimet u realizuan ne vleren 996 mije leke ose 99.6%.


Realizimi i të ardhurave dytësore

Per vitin 2012 te ardhurat jane realizuar ne shumen **5.088** mije leke me analiza si me poshte:

- nga shitja e standardeve 5.009 mije leke
- nga sekuestri me e cdemtime 76 mije leke
- nga shitja per skrap 3 mije leke

Te ardhurat nga shitja e standardeve per vitin 2012 jane realizuar ne shumen 5.009 mije leke. Krahesuar me vitin 2011 kemi rritje te te ardhurave ne vlere leku ne shumen 1.993 mije leke ose rreth 7% me shume.

Grafikisht realizimi i te ardhurave per vitin 2012 krahesuar me vitin 2011 eshte si me poshte:



Realizimi i detyrave në sektorin e burimeve njerezore

Objekt i punës së sektorit të finances, burimeve njerezore dhe sherbimeve mbeshtetese gjatë vitit 2012, ka qënë menaxhimi i drejtë i burimeve njerezore , krijimi i kushteve optimale te punes si edhe bashkerendimi i punes me menaxherin e cilesise ne DPS dhe Institutin e trajnimeve prane DAP-it per trajnimin e tyre brenda dhe jashte vendit sipas nje programi te miratuar nga Drejtori i Pergjithshem.

Sistemi i menaxhimit të cilësisë

Sistemi i menaxhimit të cilësisë në DPS është në përmirësim të vazhdueshëm. Ky sistem, gjatë çertifikimit mbi aplikimin dhe zbatimin e standardit S SH EN ISO 9001:2008, u vlerësua pozitivisht nga organizmi italian i auditimit CSQ (anëtar i rrjetit ndërkombëtar IQNET).

Gjate vitit 2012 janë rishikuar pothuajse të gjitha procedurat e punës në mënyrë që të jenë në përputhje me kërkesat e 9 kushteve për antarsimin me të drejta të plota në CEN dhe CENELEC, me kërkesat e standardit ISO 9001: 2008, si dhe duke i bërë azhurnimet e duhura referimeve (ndryshimet në legjislacion, në rregulloret e brendshme, etj) dhe databazës së re.

Objektivat për 2013

- Progres në miratimin e EN-ve si S SH;
- Fillimi i adoptimit të standardeve të publikuara nga ETSI;
- Rishikimi i arkivës së standardeve të DPS-së - shfuqizimet;
- Përdorimi dhe mirëmbajtja e Sistemit (database) të Menaxhimit të Standardeve;
- Përmirësimi i vazhdueshëm i rregulloreve dhe procedurave të punës dhe evidentimi i tyre në dosjen e 9 kushteve të CEN & CENELEC;
- Rritje e ndërgjegjësimit të operatorëve ekonomikë vendas mbi rolin e DPS-së në tregun e lirë dhe mbi rëndësinë e përdorimit të standardeve Europiane në produktet dhe shërbimet e tyre;
- Rritja e ndërgjegjësimit në lidhje me pjesëmarrjen e palëve të interesuara në procesin e standardizimit;
- Sigurimi në vijim i transparencës dhe informimit të publikut të gjerë nëpërmjet publikimeve të DPS-së (Buletinët, Katalogut të Standardeve Shqiptare dhe informimeve dhe njoftimeve të tjera të kësaj natyre)

ANEKSI 1

4.1. Chapter 1: Free movement of goods

No progress was made in the area of **general principles**.

Albania has made overall progress as regards **horizontal measures**, particularly in the fields of standardisation and conformity assessment.

There has been good progress on *standardisation*. The General-Directorate for Standardisation (GDS) continued to work towards fulfilling the conditions for applying for full membership of the European Committee for Standardization (CEN) and of the European Committee for Electrotechnical Standardization (CENELEC) in 2012. The Managing Board for Standardisation adopted internal regulations in line with CEN and CENELEC membership principles. Progress towards adopting European standards (ENs) continued. The GDS has adopted about 95.5% of ENs as Albanian standards, including all harmonised ENs. The number of standards translated remains low, as most ENs are adopted by the 'cover page' method. Standards of the European Telecommunications Standards Institute are not yet adopted at national level. The code on development, adoption, approval and implementation of standards has been approved and a working group on adoption of the national standards on oil and petrol has been established. However, no progress can be reported on the preparation of the national strategy on standardisation.

Conclusion

There has been progress in the area of free movement of goods, notably as regards standardisation. Further efforts are needed on overall legislative approximation and on establishing an adequate market surveillance inspectorate. Overall, preparations are moderately advanced.